



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 247/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Zejnepe Kamberi nga Belgjika, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën e votuesve, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si palejuar apeli Anr.247/2017 e dates 12.06.2017, e parashtruar nga Zejnepe Kamberi nga Belgjika.

A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Zejnepe Kamberi nga Belgjika, të dorëzuar nëpërmjet postes me datën 31.05.2017 në të cilën pretendohet se përmes email-it 3 herë ka bërë kërkesë për fletëregjistrim për votimi jashtë Kosove-me postë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 13.06.2017, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve-KQZ, thekson se në rastin konkret parashtruesja e ankesës përveç formularit për aplikim dhe letërnjoftimit të UNMIK-ut me afat të skaduar nuk kishte bashkangjitur asnjë dokument tjetër siç parashihet me nenin 90 të LZP-së, letërnjoftimi i vlefshëm, pasaporta valide, dokument i vlefshëm i udhëtimit, leja e vozitjes e vlefshme e Kosovës, kartela e vlefshme e PZHBV-ve, ose kartela e vlefshme e refugjatëve.

Paneli pasi e shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e apelit në bazë të nenit 122 të LZP, gjeti se :

Apeli është i palejuar:

Paneli pasi shqyrtoi të lejueshmërisë së apelit gjeti se apeli është i palejuar dhe se pretendimet të parashtruara në apel nuk gjejnë mbështetje ligjore për faktin se me vendimin e KQZ-së, afatin për miratimin e Listës Votuese Jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017, ka qenë deri më 1qershor 2017, ndërsa ankesa e ankueses në PZAP ka arritur me 12 .06.2017, pas afatit të përcaktuar nga KQZ-ja ..

Andaj me këtë rast Paneli konstaton se apeli në këtë fazë është e palejuar për tu parashtruar, në PZAP-i në kuptim të dispozitës të nenit 122.1 i LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lart e në mbështetje të dispozitës së nenit 118 par.1 të LZP-së, dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 247/2017 më datën 13.06.2017.



Kryesuesi i Panelit

Fejzullah Rexhepi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*